



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.12.2020

Dokument parlamentar

### R A P O R T

#### **PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2018, PËR PROJEKTIN “PROGRAMI PËR INFRASTRUKTURËN KOMUNALE V”**

- ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11 dhjetor 2020, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë projektligj, z. Ervin Bushati.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit.***

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin bazuar në nenet 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.***

Marrëveshja, që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj, është miratuar në shtator 2019. Ajo parashikon sigurimin e mbështetjes financiare për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V”. Ky projekt ka qëllim të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në bashkitë e përfshira në program. Nëpërmjet financimeve të parashikuara në kuadër të projektit, synohet përmirësimi i situatës së furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura në qytetet e përfshira në program, si dhe përmirësimi i treguesve të performancës për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve në bashkitë e përfshira në program.

Kjo marrëveshje është marrëveshje kuadër, në bazë të së cilës do të lidhen kontratat përkatëse të huasë dhe financimit, brenda datës 31 dhjetor 2020.

- ***Efektet financiare.***

Me anë të kësaj marrëveshjeje, të dyja qeveritë bien dakord për dhënien e mundësisë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) kreditë dhe grantet si më poshtë:

- një kredi të butë, në vlerë të përgjithshme deri në 80 milionë euro;
- një kontribut financimi për masa të nevojshme shoqëruuese deri në vlerën 3 milionë euro, për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit;
- një kontribut financimi në vlerë të përgjithshme deri në 6 milionë euro, i cili do të përdoret për investimin.

Financimi për këtë projekt është parashikuar në programin buxhetor afatmesëm 2019-2021 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjis, në programin “Ujësjellës-Kanalizime”.

- ***Diskutimi në Komision.***

Komisioni theksoi se projektligji është me rëndësi të veçantë, pasi do të vijojë të kontribuojë në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve në disa bashki të vendit. Bashkitë përfituese, shumat e financimit dhe detaje të tjera do të përcaktohen në marrëveshjet specifike financiare për këtë projekt. Financimi do të merret me kushte lehtësuese, përmes kredisë së butë dhe granteve, duke mos rënduar buxhetin. Efektet financiare të këtij projektligji janë parashikuar në PBA.

- ***Përfundim.***

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

**RELATORI**

**Ervin BUSHATI**

**KRYETARI**

**Arben AHMETAJ**